

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ARCHIPARTNERS” Sh.p.k.

Sot më datë 07.12.2024,

- Ina Musai, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan, më 27 maj 1989, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 037370988, me nr personal I95527083E,

ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (në vijim “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e tij.

Neni 1 – Emërtimi

- 1.1.1 Emërtimi i Shoqërisë është “ARCHIPARTNERS” Sh.p.k

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë (Shqipëri), Rruga “Mustafa Matohiti”, Pallati 7, kati 7.

Neni 3 – Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarie: Studio projektimi dhe shërbim konsulence në fushën arkitekturës dhe ndërtimit sipas kategorive në vijim:

(Kat 1)

b. Plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara dhe qytete

c. Studime pjesore urbanistike

(Kat2)

- Projektim arkitektonik për objekte civile-industriale-turistike-vepra arti në infrastruktërë.
- Projektim arkitektonik për objekte sportive.
- Projektim interior, dizajn.

- d. Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbëruara, lulishte e parqe. Dizenjim dhe prodhim i objekteve të dizajnit të tilla si, por pa u kufizuar në: objekte zbukurimi, të stilizuara, mobilje, tavolina, librari, karrige, objekte ndriçimi, etj.
- 4.2 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitet për llogari të të tretëve, lidhur me sa specifikohet më sipër.
- 4.3 Shoqëria do të mund të blejë, jo në kuadër të aktivitetit të saj parësor pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente, konsortiume, të themeluara apo në themelim, të cilat kanë objekt të ngjajshëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritje së qëllimeve të shoqërisë.
- 4.4 Shoqëria, gjithashtu, do të mund të zhvillojë aktivitete ndërtimi, shitblerje dhe menaxhimi të pasurive të paluajtshme.
- 4.5 Shoqëria do të mund të kryejë çdo veprim që ka të bëjë me pasurinë e luajtshme, të paluajtshme apo financiare që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, përfshirë këtu, por pa u limituar në të, nënshkrimin e marrjes së kredive me institucione të autorizuar nga ligji si dhe me shoqëri dhe ndërmarrje private.
- 4.6 Më në përgjithësi, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e nënshkruar dhe e shlyer, me një vlerë prej 100 (njëqind) Lekë.

Neni 6 – Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100 (njëqind) Lekë dhe është i nënshkruar prej Ortakut të vetëm si më poshtë:

Ina Musai, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan, më 27 maj 1989, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 037370988, me nr personal I95527083E.

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

Ina Musai zotëron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administratori

8.1 Shoqëria do të ketë 1 (një) Administrator, i emëruar prej Ortakut të Vetëm, dhe qëndron në detyrë deri në një revokim apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

8.2 Administratori i shoqërisë “ARCHIPARTNERS” do të jetë Ina Musai, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan, më 27 maj 1989, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 037370988, me nr personal I95527083E, për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

8.3 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i takon Administratorit. Administratori do të kryejë të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përjashtuar kompetencat të tilla i përkasin organeve të tjerë të Shoqërisë sipas ligjit të aplikueshëm apo sipas këtij statut.

8.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Neni 9 – Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është i përbërë nga 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Ina MUSAI

